



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 74 , datë 27.12.2022

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PUNËS TË KËSHILLIT BASHKIAK  
RROGOZHINË PËR VITIN 2023

*Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës me datë 27.12.2022 analizoi dhe diskutoi në lidhje me projektvendimin e propozuar nga Kryetarja e Këshilli, me shkresë Nr.5210.Prot datë 22.12.2022 "Për miratimin e programit të punës të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë për vitin 2023".*

Në mbështetje të nenit 113 pika 1 dhe 2, të Pjesës së Gjashtë "Qeverisja Vendore" e ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë" e ndryshuar , në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1 nënpika 1,1 gërma "b", të nenit 51 pika 3, të nenit 54 të ligjit Nr.139/2015, datë. 17.12.2015 " Për vetëqeverisjen vendore" dhe në zbatim të nenit 121 të Rregullores "Për organizmin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Rrogozhinë" miratuar me VKB nr. 7, datë 27.01.2020. Pas konsultimit me Kryetarin e Bashkisë, duke marrë sugjerimet e Konferencës së Kryetarëve dhe secilit Këshilltar, Këshillit Bashkiak ,

V E N D O S I :

1. Miratimin e programit të punës të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë për vitin 2023 sipas lidhjes bashkëlidhur këtij projekt-vendimi, si dhe listës së shpenzimeve të Këshillit sipas tabelave dhe planit bashkëlidhur këtij vendimi, për vitin 2023 në masën 220 000 (dyqind e njëzetmijë) lekë.
2. Ky program pune përgjatë vitit 2023 në rast se gjykohet e arsyeshme nga Këshilli mund të pasurohet ose ndryshohet me Vendim Këshilli sipas rastit.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendim, Këshilli Bashkiak Rrogozhinë.
4. Ky projektvendim pas miratimit në Këshilli hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar dhe pas Konfirmimit Ligjor nga ana e Prefektit të Qarkut Tiranë.

KRYETARE E KËSHILLIT  
MUKADES GIXHARI



Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email: brrrogozhine@gmail.com



## **PROGRAMIT I PUNËS I KËSHILLIT BASHKIAK RROGOZHINË PËR VITIN 2023**

### **JANAR**

1. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Dhjetor 2022 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%.
2. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Dhjetor 2022 nga fondi i pushtetit vendor.
3. Raport mbi vendimet e marra nga Këshilli Bashkiak Rrogozhinë për vitin 2022.
4. Diskutime nga komuniteti.
5. Mbledhje komisionesh të Këshillit.
6. Mbledhja Plenare e Këshillit.

### **SHKURT**

1. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2023 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%.
2. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2023 nga fondi i pushtetit vendor.
3. Raport mbi veprimtarinë e qendrës Kulturore Rrogozhinë, si dhe shqyrtim i Listës së aktiviteteve të planifikuara nga ky sektor në fushën e Kulturës dhe Turizmit për vitin 2023.
4. Raport nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Kullimit mbi masat e marra për sistemin e Kullimit dhe Vaditjes si dhe gjëndjen e Rezervuarëve në territorin e Bashkisë Rrogozhinë.
5. Diskutime nga komuniteti.
6. Mbledhje komisionesh të Këshillit.
7. Mbledhja Plenare e Këshillit.
8. Pjesëmarrje në takime dhe konferenca të ndryshme.

### **MARS**

1. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2023 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%.
2. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2023 nga fondi i pushtetit vendor.
3. Shqyrtim dhe miratim i tavanëve përgatitore për secilin program buxhetor të Bashkisë Rrogozhinë.
4. Informim i Këshillit mbi “Parandalimin e dhunës me bazë gjinore”.



5. Diskutime nga komuniteti
6. Mbledhje komisionesh të Këshillit.
7. Mbledhja Plenare e Këshillit .

## **PRILL**

1. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Mars 2023 nga fondi i Bllok – Ndhmës 6%.
2. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Mars 2023 nga fondi i pushtetit vendor.
3. Raport nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse dhe sektori i Shërbimeve Publike mbi masat e marra për përmisimin e shërbimeve ndaj qytetarit dhe përgatitjen e sezonit turistik.
4. Informacion mbi punën e bërë nga Policia Bashkiake dhe informacion nga Komisariati i Policisë mbi rendin dhe sigurinë publike.
5. Raport nga Drejtoritë përkatëse mbi zbatueshmërinë e Vendimeve të Këshillit Bashkiak për periudhën Janar - Mars 2023.
6. Konsultime për buxhetin dhe për tematika të tjera nëse lind nevoja.
7. Njohja e planit të masave për pyjet.
8. Diskutime nga komuniteti.
9. Mbledhje komisionesh të Këshillit.
10. Mbledhja Plenare e Këshillit .

## **MAJ**

1. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Prill 2023 nga fondi i Bllok – Ndhmës 6%.
2. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Prill 2023 nga fondi i pushtetit vendor.
3. Informacion nga sektori i Mbrojtjes ndaj Zjarrit (MZSH-së) mbi punën e bërë.
4. Shqyrtim dhe miratim i projekt dokumentit të programit buxhetor afatmesëm.
5. Raport nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Kullimit për masat e marra për korrijen e të lashtave dhe masat e marra ndaj zjarrit.
6. Pritje në sallën e këshillit bashkiak të Komitetit Rinor Vendor (KVR). Seancë dëgjimore dhe diskutim për çështje të ndryshme me dhe për KVR.
7. Seancë dëgjimore/diskutime për tema sensitive të ndryshimeve klimaterike.
8. Diskutime nga komuniteti.
9. Konsultime për buxhetin.
10. Mbledhje komisionesh të Këshillit.
11. Mbledhja Plenare e Këshillit.



## QERSHOR

1. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Maj 2023 nga fondi i Bllok – Ndhmës 6%.
2. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Maj 2023 nga fondi i pushtetit vendor.
3. Informacion mbi realizimin e treguesve ekonomikë të ndërmarrjes së Ujësjetës - Kanalizime Rrogozhinë dhe masat e marra për furnizimin normal me ujë të banorëve të Bashkisë dhe të zonave turistike (plazhi i Spillesë dhe i Vilë Bashtovës).
4. Raport nga Drejtoria Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun mbi punën e bërë nga ky Sektor.
5. Raport nga Administratorët e Njësisve Administrative Kryevidh, Lekaj, Gosë, Sinaballaj mbi mbarëvajtjen e punës dhe problematikat e hasura përgjatë periudhës Janar - Maj 2023.
6. Konstituimi i Këshillit të ri Bashkiak dhe betimi i Kryetarit të Bashkisë.
7. Diskutime nga komuniteti.
8. Mbledhje komisionesh të Këshillit.
9. Mbledhja Plenare e Këshillit.

## KORRIK

1. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Qershor 2023 nga fondi i Bllok – Ndhmës 6%.
2. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Qershor 2023 nga fondi i pushtetit vendor.
3. Analizë nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimit Social mbi realizimin e treguesve ekonomikë financiarë për 6 - muajin e vitit 2023.
4. Analizë nga Drejtoria e të Ardhurave dhe e Zhvillimit Ekonomik mbi realizimin e të ardhurave për 6 - muajin e parë të vitit 2023.
5. Informacion nga ZVA (Zyra Vendore Arsimore) Rrogozhinë mbi rezultatet e arritura nga përmbyllja e vitit shkollor 2022-2023.
6. Raport nga Drejtoritë përkatëse mbi zbatueshmërinë e Vendimeve të Këshillit Bashkiak për periudhën Prill – Qershor 2023.
7. Diskutime nga komuniteti.
8. Mbledhje komisionesh të Këshillit.
9. Mbledhja Plenare e Këshillit.



## GUSHT

1. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2023 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%.
2. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2023 nga fondi i pushtetit vendor.
3. Informacion nga Drejtoria e Politikave Urbane dhe nga Sektori i Kadastrës dhe Pronave për punën e bërë në drejtim të aplikimeve të lejeve on - line, projekteve të reja, procesin e legalizimit dhe evidentimin e problemeve të kadastrës dhe pronave.
4. Raport për gjëndjen ekonomiko-financiare të Bashkisë dhe Njësisë Administrative nga Kryetari i Bashkisë, sipas gërmës “ç” të nenit 64 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.
5. Diskutime nga komuniteti.
6. Mbledhje komisionesh të Këshillit.
7. Mbledhja Plenare e Këshillit.

## SHTATOR

1. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2023 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%.
2. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2023 nga fondi i pushtetit vendor.
3. Shqyrtim i Projekt Buxhetit Afatmesëm (PBA) Rrogozhinë për vitin 2024-2026.
4. Informacion mbi punën e bërë nga Sektori i Pyjeve dhe përmisimin shërbimeve dhe veprimtarisë që ofron në këtë fushë.
5. Informacion mbi punën e bërë për përgatitjen e vitit të ri shkollor nga Drejtoria e Arsimit pranë Bashkisë.
6. Masat e marra nga Sektori i Bujqësisë dhe Kullimit për pastrimin e kanaleve të para të dyta e të treta dhe përgatitja e tyre për dimrin.
7. Konstituimi i kryesive të fshatrave
8. Trajnime të këshilltarëve në bashkëpunim me OJF dhe partnere të ndysheëm si psh. Bashki të Forta, OSBE, Barazi në vendimmarrje etj.
9. Diskutime nga komuniteti.
10. Mbledhje komisionesh të Këshillit.
11. Mbledhja Plenare e Këshillit.



## TETOR

1. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shtator 2023 nga fondi i Bllok – Ndhmës 6%.
2. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shtator 2023 nga fondi i pushtetit vendor.
3. Raport nga Kryetari i Bashkisë për zbatimin e Vendimeve të Këshillit për të cilat ai dhe ekzekutivi i Bashkisë dhe Institucionet / ndërmarrjet në varësi të Bashkisë janë përgjegjës për tremujorin e fundit ose sipas rastit e përmbledhur për periudhën Janar - Shtator 2023.
4. Analizë mbi realizimin e treguesve të të ardhurave dhe shpenzimeve për 9-mujorin e vitit 2023.
5. Informacion nga Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e të Ardhurave dhe e Zhvillimit Ekonomik mbi masat që do të marrin mbi përgatitjen e Buxhetit të vitit 2024.
6. Trajnime të këshilltarëve në bashkëpunim me OJF dhe partnerë të ndyshëm si psh. Bashki të Forta, OSBE, Barazi në vendimarrje etj.
7. Diskutime nga komuniteti.
8. Mbledhje komisionesh të Këshillit.
9. Mbledhja Plenare e Këshillit.

## NËNTOR

1. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Tetor 2023 nga fondi i Bllok – Ndhmës 6%.
2. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Tetor 2023 nga fondi i pushtetit vendor.
3. Raport nga Auditi i Brendshëm mbi punën e bërë dhe problematikat e evidentuara nga ky Sektor në Administratën e Bashkisë Rrogozhinë, si dhe analizë mbi punën e bërë nga Administrata mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së në auditimin e fundit të realizuar dhe nxjerrjen e përgjegjësive në rastin e moszbatimit të këtyre rekomandimeve.
4. Raport nga Administratorët e Njësive Administrative Kryevidh, Lekaj, Gosë, Sinaballaj mbi mbarëvajtjen e punës dhe problematikat e hasura përgjatë periudhës Qershor - Tetor 2023.
5. Konsultime për buxhetin dhe për çështje të tjera.
6. Fushata ndërgjegjësuese për veprimtarinë e Këshillit.
7. Diskutime nga komuniteti.
8. Mbledhje komisionesh të Këshillit.
9. Mbledhja Plenare e Këshillit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

**DHJETOR**

1. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Nëntor 2023 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%.
2. Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Nëntor 2023 nga fondi i pushtetit vendor.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-aktit për paketën fiskale të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2024.
4. Shqyrtim dhe miratim i Projekt Buxhetit Afatmesëm Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2024- 2026.
5. Shqyrtim dhe miratim i Realizimit Faktik të Buxhetit 2023 të Bashkisë Rrogozhinë.
6. Shqyrtim dhe miratim i Buxhetit të Bashkisë për vitin 2024.
7. Shqyrtim dhe miratim i Bursave të Shkollave të Mesme për Bashkisë Rrogozhinë.
8. Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm (PBA) për vitet 2024-2026 dhe buxhetit vjetor.
9. Diskutime nga komuniteti.
10. Mbledhje komisionesh të Këshillit
11. Mbledhja Plenare e Këshillit.

**KRYETARE E KËSHILLIT  
MUKADES GIXHARI**



**Adresa:** Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com

Plani i punes Keshilli Bashkiak Rrezozhine 2023

Nr	Pershkrimi I aktivitetit	Periudha												Numri			
		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Netor	Dhjetor				
1	Mbledhje Keshilli -16 (12 edo muaj plus 4 ne total te mbledhjeve jashite radhe ose te jashtezakonshme nese do te lind nevoja)	1	1	1	2	1	1	2	1	2	1	2	1	2	1	16	
2	Mbledhje Komisionit te Perherstem (mesatarisht 3-4 mbledhje komisionesh ne muaj)	3	3	4	3	4	3	3	3	3	4	3	4	4	4	41	





Shpenzime

Kancelari	Leter	Shypshkri me	Karburant	Qera salle	Konsulenc e nga eksperte	Shpenzime per foni	Shpenzime media	Njofitime ne media	Dieta	Akomodim	Boje printer/foto kopje	Shpenzime prirje perqelije	Sherbime nga te trete per IT	Uje, Fije joalkohike	Totali shpenzimeve
														5000	5000
														5000	5000





**Keshilli Bashkiak Rrogozhine  
BUXHETI VJETOR 2023**

Nr	Emertimi i shpenzimeve	Numri	Paga dhe sigurime mujore	Vlefte vjetore
1	Honorare per Keshillin (1/10 e pages se kryetarit)	21		
2	Sekretari i Keshillit, page, sigurime shogorore	1		
	Honorare per kryetaret e fshatrave	41		
3	Administratore te lagjeve - Qytet	4		
5	Shpenzimet sipas Plani I punes I detajuar ne shpenzime ( detajuar ne sheet tjetet )			190,000
6	Shpenzime per konsultime (detajuar te plani vjetor i konsultimeve)	buxheti, paketa fiskale, shija dhenje me qera e pronave, miratimi I komisioneve te keshillit, rregullores se keshillit, plani strategjik I zhvillimit te bashkise,		30,000
Nr.	Investime			
<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>				<b>220,000</b>

**KRYETARE E KESHILLIT  
MUKADES GIXHARI**

  
